

**PASQRAT FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR ME
31 DHJETOR 2012**

Se bashku me Raportin e Audituesit

Per : **TOP LINE Sh.p.k.**

Permbajtja

	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	2
BILANCI KONTABËL (VAZHDIM)	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	6
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 17

RAPORT I AUDITORIT TE PAVARUR

Drejtuar: Ortakut të Vetëm të shoqërisë
“ TOP LINE ” shpk

Ne kemi audituar pasqyrat financiare Individuale te “ TOP LINE ” sh.p.k që përfshijnë bilancin individual më 31 Dhjetor 2012, pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e ndryshimeve ne kapitalin e vet dhe pasqyren e flukseve te parave per vitin e mbyllur ne kete date si dhe një permbledhje të politikave kontabël kryesore dhe shënime të tjera shpjeguese.

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësira; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme per rrethanat.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin procedura për të marrë prova auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektetivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Nje auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërine e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare Individuale paraqesin ne menyre te sinqerte ne te gjitha aspektet materiale gjendjen financiare te “ TOP LINE ” sh.p.k me 31.12.2012 te rezultatit financiar dhe te flukseve te saj te parave ne fund te vitit te mbyllur ne kete date ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.


ILD-99 Audit shpk

Irena Hoxha (Pulo)

Rruga “ Ismail Qemali ” pall 34/1 Ap 2/1

Tiranë, më 12 Mars 2013



Top Line sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

AKTIVET	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Mjetet Monetare	4	3,959,669	615,123
Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim		-	-
<i>Derivatet</i>		-	-
<i>Aktivet e mbajtur per tregtim</i>		-	-
Totali		3,959,669	615,123
Aktive te tjera Financiare afatshkurter			
<i>Llogari kerkesa te arketueshme</i>	5	7,358,881	21,837,888
<i>Llogari kerkesa te tjera te arketueshme</i>	6	1,238,232	1,113,645
<i>Instrumente te tjera borxhi</i>		-	-
<i>Investime te tjera financiare</i>		-	-
Totali		8,597,113	22,951,533
Inventari			
<i>Lendet e para</i>		-	-
<i>Prodhimi ne proces</i>		-	-
<i>Produkte te gatshme</i>	7	40,291,564	32,167,750
<i>Mallra per rishitje</i>		-	-
<i>Inventar I imet</i>		-	-
<i>Parapagesat per furnizime</i>	8	291,895	708,761
Totali		40,583,459	32,876,511
<i>Aktive Biologjike afatshkurter</i>		-	-
<i>Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje</i>		-	-
<i>Parapagime dhe shpenzime te shtyra</i>	9	582,031	719,318
Total i Aktiveve Afatshkurtra		53,722,272	57,162,485
Aktive Afatgjata			
Investime financiare afatgjata		-	-
<i>Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara</i>		-	-
<i>Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje</i>		-	-
<i>Aksione dhe letra te tjera me vlere</i>		-	-
<i>Llogari kerkese te arketueshme</i>		-	-
Totali		-	-
Aktive Afatgjata Materiale			
<i>Toka</i>		-	-
<i>Ndertesa ne Proces</i>		-	-
<i>Makineri dhe pajisje (neto)</i>		1,689,779	2,112,227
<i>Aktive te tjera afatgjata materiale (neto)</i>		3,958,474	4,770,026
Totali	10	5,648,253	6,882,253
Aktive Biologjike Afatgjate		-	-
Aktive Afatgjata Jomateriale		-	-
<i>Emri i mire</i>		-	-
<i>Shpenzimet e zhvillimit</i>		-	-
<i>Aktive te tjera afatgjata jomateriale</i>		-	-
Totali		-	-
<i>Kapitali aksionar i papaguar</i>		-	-
<i>Aktive te tjera afatgjata (ne proces)</i>		-	-
Totali i Aktiveve Afatgjata		5,648,253	6,882,253
TOTALI I AKTIVEVE		59,370,525	64,044,738

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre



Top Line sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012


(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012 (vazhdim)

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Detyrimet Afatshkurta		38,391,932	43,458,607
Derivatet		-	-
Huamarrjet		-	-
Huate dhe obligacionet afatshkurtra	11	9,861,528	7,067,293
Kthimet/Ri pagimet e huave afatgjata		-	-
Bono te konvertueshme		-	-
Totali		9,861,528	7,067,293
Huate dhe parapagimet			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	12	2,101,664	9,758,890
Te pagueshme ndaj punonjesve		-	-
Detyrimet tatimore	13	315,763	244,638
Detyrime te tjera	14	26,112,977	26,387,786
Parapagimet e arketueshme		-	-
Totali		28,530,404	36,391,314
Grantet dhe te ardhura te shtyra		-	-
Provizionet afatshkurtra		-	-
Totali Detyrime Afatshkurtra		38,391,932	43,458,607
Detyrimet Afatgjata		-	-
<i>Huate afatgjata</i>			
Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		-	-
Bonot e konvertueshme		-	-
Totali		-	-
Huamarrje te tjera afatgjata		-	-
Provizionet afatgjata		-	-
Grandet dhe te ardhura te shtyra		-	-
Totali Detyrime Afatgjata		-	-
Totali i Detyrimeve		38,391,932	43,458,607
Kapitali			
Akisonet e pakices		-	-
Kapitali i aksionereve te shoqerise meme		-	-
Kapitali i aksionar		13,000,000	13,000,000
Primi i aksionit		-	-
Njesite ose aksionet e thesarit		-	-
Rezerva statutore		-	-
Rezerva ligjore		919,655	775,655
Rezerva te tjera		-	-
Fitimi i pashperndare		3,923,987	3,923,987
Fitimi (humbje) e vitit financiar		3,134,951	2,886,489
Totali i Kapitalit	15	20,978,593	20,586,131
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		59,370,525	64,044,738

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre



Top Line sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012


(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

Te ardhura e shpenzime	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Te Ardhurat	16	86,909,713	107,353,256
Shitjet neto		86,722,551	107,353,256
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		187,162	-
Ndryshimet në inventarin e produktevetë gatshme dhe prodh		-	-
Materiallet e konsumuara	17	(68,047,066)	(90,116,976)
Kosto e punës	18	(5,779,674)	(5,492,188)
-pagat e personelit		(5,160,000)	(4,930,800)
-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(619,674)	(561,388)
-shpenzime per honorare		-	-
Amortizimet dhe zhvlerësimet	19	(1,395,492)	(630,037)
Shpenzime të tjera	20	(8,823,195)	(7,698,304)
Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		(84,045,427)	(103,937,505)
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore(1+2+/-3-8)		2,864,286	3,415,751
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësi të e kontrol		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare			
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjer		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	21	(418,116)	(377,701)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	22	142,063	165,422
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	23	1,006,389	180,537
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare(12.1+/-12.2)		730,336	(31,742)
Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)		3,594,622	3,384,009
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	24	(459,671)	(497,520)
Tatim Fitimi i Shtyre		-	-
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar(14-15)		3,134,951	2,886,489

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre





PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

Pasqyra e fluksit monetar-Metoda indirekte	Viti 2012 ne LEK	Viti 2011 ne LEK
I Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi para tatimit	3,594,622	3,384,009
Rregullime per:		
Amortizimin	1,395,492	630,037
Humbje nga kembimet valutore		82,007
Te ardhura nga investimet		
Shpenzime per interesa	418,116	377,701
(Rritje) / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesa te arketueshme te tjera	14,354,420	(17,164,749)
(Rritje) / renie ne tepricen e inventarit	(7,706,948)	5,053,533
Rritje / (renie) ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti	(5,066,675)	14,977,165
Rritje /Renie ne shpenzimet e shtyra	137,287	646,882
Interesi i paguar	(418,116)	(377,701)
Tatim mbi fitimin i paguar	(459,671)	(449,066)
MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit	6,248,527	7,159,818
II Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
Blerja e shoqerise se kontrolluar X minus parate e arketuara		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(161,492)	(5,306,694)
Te ardhura nga shitja e paisjeve		
Interesi i arketuar		
Dividentet e arketuar		
MM neto e perdorur ne aktivitetet investuese	(161,492)	(5,306,694)
III Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		
Te ardhura nga huamarrje afatgjata		
Pagesat e detyrimeve te qirase financiare		
Dividentet e paguar	(2,742,489)	(2,926,678)
MM neto e perdorur ne aktivitetet financiare	(2,742,489)	(2,926,678)
Rritja / renia neto e mjeteve monetare	3,344,546	(1,073,554)
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	615,123	1,688,677
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	3,959,669	615,123

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre

Top Line sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT


Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore statutore	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i Ushtrimit	Totali
Pozicioni më 01.01.2011	13,000,000	775,655	3,923,987	2,926,677	20,626,319
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël	-	-	-	2,886,489	2,886,489
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	(2,926,677)	(2,926,677)
Dividendët e paguar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31.12.2011	13,000,000	775,655	3,923,987	2,886,490	20,586,132
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël	-	-	-	3,134,951	3,134,951
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	(2,742,490)	(2,742,490)
Dividendët e paguar	-	144,000	-	(144,000)	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	919,655	3,923,987	3,134,951	20,978,593
Pozicioni më 31.12.2012	13,000,000	919,655	3,923,987	3,134,951	20,978,593

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre

Pasqyrat Financiare u miratuan dhe u firmosen nga administratori i shoqerise

Znj. Margarita Kalaj



TOP LINE Sh.p.k

Strada e 28 Nëntorit, Nr. 10, Tiranë

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI SHOQERINE

a. Te Pergjithshme

Shoqeria TOP LINE Shpk eshte krijuar ne 12.07.2002 me vendim gjykate Nr. 28036 date 12.07.2002 Vepretimaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregtare" dhe nga statuti i saj.

Perfaqesues ligjor i shoqerise eshte :

- Zj. Margarita Kolaj

Shoqeria me 31 Dhjetor 2012 ka 8 punonjes te regjistruar.

Selia e shoqerise ndodhet ne Bulevardin "Bajram Curri ", Rruga Hodo Bega, Tirane
Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte tregeti artikuj mobilje te ndryshme dhe zyre, Import -Export etj.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.3 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

TOP LINE Sh.p.k
arredo casa&ufficio
Tel. 00355 42 229797

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

	31.12.2012	31.12.2011
Kurse e kembimit		
Euro/Leke	139.59	138.93
USD/ Leke	105.85	107.54

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (Mjete monetare)

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që



llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. POLITIKAT KONTABËL

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali njihet me vlerën nominale

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.


Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

iii. *Amortizimi (vazhdim)*

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Makineri dhe pajisje	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	25%
Mjete Transporti	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Zhvlerësimi

i. *Aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

TOP LINE Sh.p.k
arreda casa&ufficio
Tel. 00355 42 229777 10

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.8 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. LIKUIDITETE DHE VLERA TE TJERA ARKE.

Gjendja e likuiditeteve rakordon me shumën e ekstrakteve të bankave dhe gjendjes së arkës në 31.12.2012. Shoqëria ka llogari bankare në lekë dhe në valute. Për gjendjet në valute është bërë rivlerësimi me kursin fikse të Bankës së Shqipërisë në dt. 31.12.2012 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e shoqërisë

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Vlera monetare ne LEK	263,221	36,459
Banka	141,973	13,848
Arka	121,248	22,611
Vlera monetare ne Valute	3,696,448	578,664
Banka	3,694,216	573,910
Arka	2,232	4,754
Total	3,959,669	615,123

TOP LINE Sh.p.k
 CHITTO Casa&ufficio
 Tel. 06355 42 22777 11

5. KERKESA TE ARKETUESHME

Shuma e pasqyruar ne bilanc perfaqeson kerkesat per arketim ndaj klienteve te shoqerise. Kjo shume perfaqeson detyrimin e te treteve ndaj shoqerise per fatura te palikuiduara. Te gjitha kerkesat janë të arkëtueshme Per klientet ne valute eshte bere rivleresimi i tyre me kursin fiks te bankes se Shqiperise dhe diferencat jane paraqitur ne pasqyren e rezultatit te ushtrimit.

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Kliente	7,358,881	21,837,888
Total	7,358,881	21,837,888

6. TE TJERA KERKESA PER ARKETIM

Ne kete ze paraqitet tatim fitimi i mbipaguar si me poshte dhe TVSH-ja e parapaguar ndaj Doganes:

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Tatim Fitimi	1,211,494	1,113,645
TVSH per t'u sistemuar	26,738	-
Total	1,238,232	1,113,645

7. INVENTARET

Ne kete ze paraqitet shuma e mallrave te blera nga shoqeria per tu rishitur te cilat me 31.12.2012 rezultojne gjendje. Vleresimi i tyre fillestar eshte bere me kosto. Shoqeria ndjek metoden e inventarit te ndermjetem. Vleresimi i mallrave ne fund eshte bere me me te voglen midis kostos dhe vleres neto te realizueshme.

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Mallra per rishitje	40,291,564	32,167,750
Total	40,291,564	32,167,750

8. PARAPAGIME PER FURNIZIME

Ne kete ze jane paraqitur shumat e parapaguara per furnitoret e mallrave ne mbyllje te vitit ushtrimor per furnizime si me poshte:

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Parapagime per furnizime	291,895	708,761
Total	291,895	708,761

TOP LINE Sh.p.k
 ardo casa ufficio
 tel. 00355 42 229797

9. SHPENZIME TE SHTYRA

Ne kete ze eshte paraqitur shuma e shpenzimeve te cilat jane shtyre ne vitin 2012 te cilat lidhen me riparime te ambienteve te ekspozites dhe prime te sigurimeve te cilat i takojne vitit 2013.

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Shpenzime te shtyra	582,031	719,318
Total	582,031	719,318

10. AKTIVET E AFATGJATA MATERIALE (AAM)

	MOBILJE E ORENDI	MJETE TRANSPORTI	PAJISJE KOMJUTERIKE	PAJISJE ZYRE INSTALIME TEKNIKE	TOTAL
Me Kosto					
Ne 1 Janar 2012	3,772,692	2,411,650	1,063,642	1,405,100	8,653,084
Shtesa	161,486	-	-	-	161,486
Pakesime	-	-	-	-	-
Ne 31 Dhjetor 2012	3,934,178	2,411,650	1,063,642	1,405,100	8,814,571
Amortizimi i Akumuluar					
Ne 1 Janar 2012	53,825	299,420	682,554	735,022	1,770,822
Riklasifikim	-	-	-	-	-
Amrtizimi i vitit	743,763	422,446	95,271	134,016	1,395,496
Kthim amortizimi	-	-	-	-	-
Ne 31 Dhjetor 2012	797,589	721,866	777,826	869,038	3,166,318
Neto me 1 Janar 2012	<u>3,718,867</u>	<u>2,112,230</u>	<u>381,088</u>	<u>670,078</u>	<u>6,882,263</u>
Neto me 31 Dhjetor 2012	<u>3,136,590</u>	<u>1,689,784</u>	<u>285,817</u>	<u>536,062</u>	<u>5,648,253</u>

Amortizimi eshte llogaritur sipas normave percaktuara dhe eshte paraqitur ne vleren 1,395,496 Leke per vitin 2012.

11. HUATE DHE OBLIGACIONET AFTASHKURTRA

Ne kete ze paraqitet Huaja e marre ne banke gjate vitit 2012 dhe interesat te cilat i perkasin muajit Dhjetor, te paguara ne Janar 2013.

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Hua Afatshkurter	9,771,300	7,067,293
Interesa per muajin Dhjetor	90,228	-
Total	9,861,528	7,067,293

TOP LINE Sh.p.k
 credo casa&ufficio
 Tel. 00355 42 229797
 13

12. FURNITORET

Ne kete ze paraqiten detyrimet e palikujduara te shoqerise ndaj furnitoreve per mallra e sherbime ne mbyllje te vitit ushtrimor. Per furnitoret ne valute eshte bere rivleresimi i tyre me kursin fiks te bankes se Shqiperise dhe diferencat jane paraqitur ne pasqyren e rezultatit te ushtrimit.

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Furnitore per mallra e sherbime	2,063,257	9,609,671
Furnitore per fatura te pamberritura	38,407	149,219
Total	2,101,664	9,758,889

13. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore perfaqesojne Shumen e Sigurimeve dhe Tatimit mbi te ardhurat personale te muajit Dhjetor 2012 si dhe detyrimin e TVSH-se per muajin Dhjetor 2012.

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Sigurime Shoq. & Shendetsore	68,355	91,423
Tatim Page	19,500	44,000
TVSH per t'u paguar	227,908	109,215
Total	315,763	244,638

14. TE TJERA DETYRIME


Ne kete ze jane paraqitur detyrimi i shoqerise per hua ndaj te treteve ne shumen 19,113,340 Leke si dhe detyrimi per dividente te papaguar qe lidhen me fitimin e viteve te kaluara.

	2012	2011
	ne LEK	ne LEK
Hua te tjera	19,113,340	21,908,456
Dividente per t'u paguar	6,897,671	4,429,431
Drejt Rajonale Sigurimeve	90,596	
Detyrime ndaj bashkise	11,370	49,899
Total	26,112,977	26,387,786

> KAPITALI I VET**a. Kapitali I nenshkruar**

Kapitali themeltar i regjistruar ne gjykate eshte po ai i paraqitur ne ketë ze per vleren 13,000,000 lekë.

Rezerva ligjore paraqitet per shumen 919,655 leke.



b. Fitime ose humbie te mbartura

Paqyrohet ne bilanc me vleren 3,923,987 leke, qe perfaqeson fitimin e shoqerise te mbartur nga vitet e kaluara. Ne vitin 2012 Asambleja e Ortakeve ka marre vendim per shperndarjen e fitimi te vitit 2011 ne shumen 2,742,489 leke dhe te kaloj ne rezerva ligjore shumen 144,000 leke.

c. Fitime ose humbie te ushtrimit

Ne kete ze eshte paraqitur fitimi neto i vitit ushtrimor pas llogaritjes se tatimit mbi fitimin ne shumen 3,134,951 leke.

15. TE ARDHURAT

Te ardhurat jane realizuar nga veprimtaria kryesore e shoqerise si me poshte. Ato rakordojne me shumen e te ardhurave te deklaruar ne FDP gjate vitit 2012:

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Te ardhura nga shitja	86,722,551	107,353,256
Te ardhura te tjera	187,162	-
	86,909,713	107,353,256

16. SHPENZIME PER MALLRA E MATERIALE



Ne kete ze jane paraqitur shpenzimet per blerjen e mallrave si me poshte:

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Blerje mallrash	68,047,066	90,116,976
Total	68,047,066	90,116,976

17. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit perbehen nga shpenzimet per paga dhe shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore. Keto shpenzime perputhen me shpenzimet e deklaruar ne FDP gjate vitit 2012.

	2012 ne LEK	2011 ne LEK
Pagat e personelit	5,160,000	4,930,800
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	619,674	561,388
Total	5,779,674	5,492,188

18. SHPENZIMET E AMORTIZIMIT

	2012	2011
	<i>ne LEK</i>	<i>ne LEK</i>
Shpenzimi Amortizimi	<u>1,395,492</u>	<u>630,037</u>
Total	<u>1,395,492</u>	<u>630,037</u>


19. SHPENZIME TE TJERA ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e tjera administrative jane analizuar ne tabelen e meposhtme:

	2012	2011
	<i>ne LEK</i>	<i>ne LEK</i>
Karburant	577,812	225,293
Sherbim interneti/telefon	585,870	986,922
Publicitet/Reklama	1,644,011	99,258
Sherbime doganore	42,265	476,500
Qira	3,154,761	1,687,026
Sherbime Konsulence Juridike dhe Financiare	120,000	193,333
Sigurime	221,119	143,245
Transport	-	122,003
Mirembajtje dhe riparime	258,364	1,329,238
Shpenzime pritje percjellje	-	131,833
Te tjera	<u>2,218,993</u>	<u>2,303,654</u>
Total	<u>8,823,195</u>	<u>7,698,304</u>

20. TE ARDHURA DHE SHPENZIME NGA INTERESA

	2012	2011
	<i>ne LEK</i>	<i>ne LEK</i>
Shpenzime per interesa	(439,026)	(378,374)
Te ardhura per interesa	20,910	673
Total	<u>(418,116)</u>	<u>(377,701)</u>



21. FITIM (HUMBJE) NGA KURSI I KEMBIMIT

Diferencat nga ndryshimi i kursit te kembimit jane paraqitur neto ne Pasqyren e Rezultatit dhe perbehen nga fitime/(humbje) perkatesisht sipas tabelës se meposhtme:

	2012 <i>ne LEK</i>	2011 <i>ne LEK</i>
Humbje nga kursi i kembimit	(570,936)	(715,044)
Fitime nga kursi i kembimit	712,999	880,466
Total	142,063	165,423

22. TE ARDHURA DHE SHPENZIME TE TJERA FINANCIARE

	2012 <i>ne LEK</i>	2011 <i>ne LEK</i>
Te ardhura financiare	1,006,389	180,537
Shpenzime financiare	-	-
Total	1,006,389	180,537

23. STRUKTURA E REZULTATIT TATIMOR

Struktura e rezultatit me 31 dhjetor 2012 paraqitet si me poshte:

	2012 <i>ne LEK</i>	2011 <i>ne LEK</i>
Rezultati tatimor		
Fitimi/(Humbja) para tatimit	3,594,622	3,384,009
Shpenzime te panjohura	1,002,088	1,591,188
Fitimi fiskal	4,596,710	4,975,197
Tatim fitimi (10 %)	459,671	497,520
Fitimi/(Humbja) Neto	3,134,951	2,886,489

24. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

